



KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETSKA KORPORACIJA KOSOVA d.d.

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVËS sh.a.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
KOSOVSKA ENERGETSKA KORPORACIJA d.d.

12-08-2024

5288

Nr. Udhëzimit Administrativ nr.

PRISHTINE

Bazuar në nenin 8 të Ligjit të Punës, Kodin e punës së KEK Sha, si dhe në bazë të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit në sektorin publik si dhe nevojave emergjente të paraqitura për plotësimin e vendeve të lira të punës në Divizionin e Financiar të KEK-ut, UD Kryeshefi Ekzekutiv i KEK-ut autorizon Drejtorin e Burimeve Njerëzore, më 12.08.2024 që të publikojë ofertën për pozitën e mëposhtme:

KONKURS

Titulli i pozitës:	<u>Menaxher i Materialit dhe Inventarit</u>
Institucioni:	Korporata Energjetike e Kosovës (Divizionin Financiar)
Numri i referencës:	06 -12.08.2024
Tipi Akt Emërimit të punës:	Sipas Ligjit të punës 03/L-2012 dhe UA01/2024
Titulli i mbikëqyrësit	I raporton Menaxherit të Kontabilitetit Qendror
Kohëzgjatja e kontratës:	1 (një) vjeçare me mundësi vazhdimi, ndërsa puna provuese 6 (gjashtë) muaj.
Koeficienti-paga:	1340 euro
Procedura e aplikimit:	I jashtëm
Numri i kërkuar:	1
Vendi i punës:	Prishtinë

DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË:

Bartësi i vendit të punës është përgjegjës për interpretimin dhe aplikimin e SNRF-ve që ndërlidhen me Inventarin. Përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e regjistrimeve kontabël për Inventarin. Përgjegjës për monitorimin dhe kontrollin e aktiviteteve të materialit dhe inventarit (regjistrimi, hyrjet, transferet, daljet, dëmtimi, provizionimi, shlyerja, inventarizimi etj). Raportimi me kohë dhe i drejtë i aktiviteteve që ndërlidhen me taksat sipas kërkesës së legjislacionit në fuqi si në ATK, po ashtu edhe në institucionet tjera. Zhvillimi dhe mbikëqyrja e implementimit të politikave të kontabilitetit të inventarit të kompanisë. Sigurimi i përputhshmërisë financiare, menaxhuese, i taksave dhe kërkesave raportuese rregullative. Udhëheqja, zhvillimi dhe implementimi i sistemit qarkullues të dokumenteve të kompanisë. Krijimi i doracakëve të kontabilitetit, udhëzimeve dhe interpretimeve. Përcaktimi dhe mbikëqyrja e procedurave të kontabilitetit të inventarit në kompani. Mbikëqyrja e punimeve ditore të departamentit të kontabilitetit të Inventarit. Sigurimi që organizimi i sistemeve të automatizuara informative të kontabilitetit është në përputhje me interpretimin dhe aplikimin e standardeve të kontabilitetit dhe regjistrat të jenë të mirëmbajtura në përputhje me rregulloret e kompanisë. Rekomandimi i ndryshimeve dhe përmirësimet në sistemet informative të automatizuara financiare dhe menaxhuese të kompanisë. Krijimi dhe implementimi i qëllimeve afatshkurta dhe afatgjata të departamenteve, objektivave, rregulloreve dhe procedurave punuese. Krijimi dhe mirëmbajtja e përshtatshme e kontrollit të brendshëm mbrojtës. Përgatitja e raporteve financiare mujore, tremujore dhe vjetore në përputhje me SNRF dhe politikat e procedurat e Kompanisë. Përgatitja e raportit zyrtar vjetor sipas SNRF-ve dhe legjislacionit tatimor. Përcaktimi i objektivave të departamentit të kontabilitetit të Inventarit dhe raporti i arritjes së tyre. Integriteti profesional në përputhje me misionin, vizionin dhe vlerat e kompanisë. Detyra të tjera sipas caktimit.

Kërkesat profesionale/Kualifikimet

1. Bachelor në Financa ose Kontabilitet. Preferohet Master në Financa ose Kontabilitet.
2. Minimum Teknik i Kontabilitetit nga organizatat e licensuara në Kosovë. Preferohet niveli Kontabilist i Çertifikuar nga organizatat e licensuara në Kosovë.
3. Njohuri të financave, të kontabilitetit dhe të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.
4. Njohuri të kontabilitetit financiar tatimor.
5. Minimum 3 vite përvojë pune profesionale në kontabilitet ose financa.
6. Njohuri profesionale komunikuese me shkrim dhe në të folur dhe aftësi ndër-personale.
7. Njohja e gjuhës angleze.
8. Njohje të mirë të programeve kompjuterike, Office 365 në veçanti Excel si dhe programeve të kontabilitetit.

Dokumentet qe duhet te dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyra e dorëzimit te tyre:

Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe te plota, duhet të keni kujdes në pikat vijuese:

- a. Aplikacionin e shkarkuar nga ueb faqja e KEK-ut e plotësoni, pas plotësimit duhet të ngarkohet në formën e aplikimit online te vegëza: **“Ngarko Aplikacionin e plotësuar”**
- b. Dëshmia për kualifikimin tuaj: **Diplomën e fakultetit dhe të masterit (nëse keni) , përvojën e punës (kontratat e punës dhe pasqyra e trustit pensional)** (i skanoni ne një dokument të vetëm (formati .pdf ose .docx ose .doc, madhësia maksimale **5 MB**) dhe pastaj e ngarkoni në aplikimin online të vegëza **“Ngarko dëshmitë e kualifikimit”**. Nëse diploma është e fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës se fituar apo aktin qe dëshmon se diploma e fituar është ne procedurë te nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në atë pozitë.

Mënyra e aplikimit për këtë pozitë : Aplikimi është online, ngarkoni dokumentet sipas kërkesave në konkurs. Aplikimi juaj është i kompletuar vetem nese e merrni e- malin konfirmues. Për çdo paqartësi dhe për siguri në aplikim kontaktoni në numrin e telefonit: 038 501-401-2671, por mund të shkruani edhe në e-mailin (ofertapune@kek-energy.com) për të vërtetuar aplikimin tuaj (vetem nese nuk keni pranuar e-malin konfirmues).

Njoftimi me rezultatin e konkursit publik : Lista e kandidatëve të cilët i plotësojnë kushtet për pranim do te shpallen ne tabelën e shpalljes në KEK, por kandidatët individualisht do të njoftohen me rezultatin e këtij konkursi duke e respektuar Udhëzimin administrativ nr. 01/2024 për rregullimin e konkursit ne sektorin publik.

Mënyra e vlerësimit të aplikantëve/kandidatëve: Sipas **UA01/2024, Neni 13 Kriteret e vlerësimit, Pika 2:**

- Për këtë pozitë nuk kërkohet testim me shkrim, jetë përshkrimi (CV) i kandidatit vlerësohet deri në tridhjetë (30) pikë, ndërsa intervista vlerësohet deri në shtatëdhjetë (70) pikë.

Procesi i intervistimit për kandidatët e suksesshëm me qëllim të transparencës do të monitorohet nga kamerat.

KEK-u fton të gjithë të interesuarit, në veçanti ato të gjinisë femërore, të aplikojnë për pozitën e publikuar.

Për më shume informata për pozitën e lartpërmendurë vizitoni web faqen: www.kek-energy.com, ikona ‘Shpallje’ dhe mund ta shkarkoni aplikacionin për pozitën që dëshironi të aplikoni.

Në rast të pikëve të barabarta në fund të testimit (me shkrim dhe me gojë) përparësi do të kenë kandidatët nga komuna e Obiliqit dhe zonat tjera të rrezikuara konform ligjit nr. 05/l-044.

Vërejtje: Gjatë aplikimit online, pas plotësimit të fushave me të dhënat personale të sakta dhe të plota, duhet të keni kujdes si në vijim: Nëse nuk e deklaroni që anëtar i familjes së ngushtë ju punon në KEK, ne cilëndo fazë që vërtetohet aplikacionet e juaja do të refuzohen. Aplikacionet pas afatit nuk do të pranohen, ndërsa ato të mangëta ose që nuk janë ne formatin e kërkuar më lartë do të refuzohen. Kandidati i suksesshëm do të sistemohet në pozitën për të cilën ka aplikuar sipas kësaj shpallje dhe në afatin prej 3 (tre) viteve nga dita e kontratës se parë nuk ka të drejtë ri-sistemimi në vend tjetër të punës, përveç në raste të jashtëzakonshme me lejinim e KE të KEK. Kalendar i për afërt: brenda 25 dite testi me shkrim, brenda 25 dite intervistat me gojë dhe njoftimi final brenda 30 dite nëse nuk ka ankesa të cilat e pezullojnë afatin e paraparë sipas UA01/2024.

Data e aplikimit deri më **27.08.2024 ora 24:00**

Prishtinë, **12.08.2024**

